



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORI

Nr. 1492/2 Prot.

Tiranë, më 22.10 2021

V E N D I M

Nr. 199 dt. 22.10 2021

**PËR SHPALLJEN E KONKURISIT PËR PRANIMIN E 4 (KATËR) PUNONJËSVE,
PERSONEL AKADEMIK ME KOHË TË PJESSHME "LEKTOR" DHE "ASISTENT
LEKTOR" NË FAKULTETIN E VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT
PRANË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS**

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", Kreu VI, PERSONELI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË, në VKM nr. 123, datë 17.02.2010 "Për krijimin e Universitetit të Sporteve të Tiranës", në shkresat e FVFR me nr. 1492/1 prot., datë 20.10.2021 "*Kërkesë për personel akademik me kohë të pjesshme në Departamentin e Lëvizjes dhe Shëndetit për vitin akademik 2021-2022*", nr. 1496/1 prot., datë 20.10.2021 "*Kërkesë për personel akademik me kohë të pjesshme në Departamentin e Aktivitetit Fizik, Rekreacionit dhe Turizmit për vitin akademik 2021-2022*", Rektori,

V E N D O S I :

Shpalljen në web-in [http:// www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al) të procedurave të aplikimit për personelin akademik me kohë të pjesshme në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit sipas lëndëve dhe moduleve të poshtëshënuara:

I. DEPARTAMENTI I LËVIZJES DHE SHËNDETIT

1 (një) Lektor në lëndën:

- **Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti**, (Mod. Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti, Parandalimi i sëmundjeve) "Master Shkencor".

1 (një) Asistent Lektor në lëndën:

- **Terapia e Lëvizjes** (Mod. Terapia e Lëvizjes) "Bachelor".

II. DEPARTAMENTI I AKTIVITETIT FIZIK REKREACIONIT DHE TURIZMIT

1 (një) Lektor në lëndët:

- Disiplina Rekreative II, (Mod. Danc-Folk0.”Bachelor”
- Lëndë me Zgjedhje, (Mod. Koreog, Art Lëvizje) “**Bachelor**”
- Disiplinat e Sporteve Individuale Rekreative, (Mod. Kompozim Danc) ”M. Profesional”.
- Aktiviteti Fizik në Sportet Individuale, (Mod. Koreografi) “Master Shkencor”.

1 (një) Lektor në lëndët:

- Turizëm, (Mod. Gjeografi Turistike, Arkeologji, Monumente Kulture) “M. Shkencor”
- Turizëm, (Mod. Eksplorim Turistik,) “M. Shkencor”.

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për Lektor, në lëndën: “**Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti**, (Mod. Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti, Parandalimi i sëmundjeve) “Mastër Shkencor” në Departamentin e Lëvizjes dhe Shëndetit janë si më poshtë:

Kritere të përgjithshme:

1. Kandidati duhet të mbajë të paktën gradën shkencore “Doktor”.
(Grada shkencore e mbrojtur në institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njehsuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
2. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës.
3. Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në mësimdhënie në institucionet e arsimit të lartë brenda apo jashtë vendit.
4. Të ketë veprimtari kërkimore– shkencore dhe botime në disiplinën përkatëse.
5. Të plotësojë kriteret e propozuara nga njësia bazë përkatëse.
6. Të përmbushë kriteret që përcaktohen nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
7. Të mos ketë prishur apo cënuar imazhin e UST-së.
8. Dëshmi e penalitetit/formular i vetëdeklarimit.

Kritere specifike :

1. Të ketë mbaruar studimet e larta universitare me notën mesatare mbi 8 (tetë).
2. Kandidati duhet të mbajë të paktën gradën shkencore “Dr., Prof. Asc.Dr., Prof.Dr.”
3. Diplomimi duhet të jetë në fushën e lëndëve Bio-Mjekësore.
4. Të ketë kryer aktivitete shkencore si: referime, botime brënda dhe jashtë vendit.
5. Të ketë pwrvojë pune në fushën e lëndës.

Kritere preferenciale:

1. Kanë preferencë kandidatët që kanë kryer kualifikime në nivel pasuniversitar që i përkasin fushës së lëndës në departamentin ku aplikon.
2. Të ketë specializim pasuniversitar.

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për Asistent Lektor, në lëndën: “**Terapia e Lëvizjes**, (Mod. Terapia e lëvizjes) “Bachelor” në Departamentin e Lëvizjes dhe Shëndetit janë si më poshtë:

Kritere të përgjithshme:

1. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës.
2. Të zotërojë së paku diplomë të ciklit të dytë, Master i Shkencave ose ekuivalent me të, në fushën e kërkuar. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri)
3. Kandidati duhet të ketë notë mesatare të studimeve Bachelor dhe Master i Shkencave ose ekuivalent me të mbi 8.
4. Kandidati duhet të zotërojë me dëshmi së paku një nga 5 gjuhët e Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht).
5. Kandidati të mos ketë prishur ose dëmtuar imazhin e UST-së.
6. Kandidati të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Kritere specifike :

1. Të ketë mbaruar studimet e larta universitare me notën mesatare mbi 8 (tetë).
2. Kandidati duhet të mbajë Diplomën “Master i Shkencave” ose DIND.
3. Diplomimi duhet të jetë në fushën e lëndëve Bio-Mjekësore.
4. Të ketë kryer aktivitete shkencore si: referime, botime brënda dhe jashtë vendit.
5. Të ketë eksperiencë në mësimdhënie në IAL.

Kritere preferenciale:

1. Kanë preferencë kandidatët që kanë kryer kualifikime në nivel pasuniversitar që i përkasin fushës së lëndës në departamentin ku aplikon.

III. DEPARTAMENTI I AKTIVITETIT FIZIK REKREACIONIT DHE TURIZMIT

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për Lektor, në lëndët “Disiplina Rekreative II, (Mod. Danc-Folk.)” Bachelor”, Lëndë me Zgjedhje, (Mod. Koreog, Art Lëviz,) “Bachelor”, Disiplinat e Sporteve Individuale Rekreative, (Mod. Kompozim Danci) “M. Profesional”, Aktiviteti Fizik në Sportet Individuale, (Mod. Koreografi) “Master Shkencor”, janë si më poshtë:

Kritere të përgjithshme:

1. Kandidati duhet të mbajë të paktën gradën shkencore “Doktor”.
(Grada shkencore e mbrojtur në institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
2. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës.
3. Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në mësimdhënie në institucionet e arsimit të lartë brenda apo jashtë vendit.
4. Të ketë veprimtari kërkimore– shkencore dhe botime në disiplinën përkatëse.
5. Të plotësojë kriteret e propozuara nga njësia bazë përkatëse.
6. Të përmbushë kriteret që përcaktohen nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
7. Të mos ketë prishur apo cënuar imazhin e UST-së.

8. Dëshmi e penalitetit/formular i vetëdeklarimit.

Kritere specifike :

1. Kandidati duhet të mbajë të paktën gradën shkencore “Doktor”.
(Grada shkencore e mbrojtur në institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njehsuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
2. Të ketë mbaruar studimet e larta universitare me notën mesatare mbi 8 (tetë).
3. Të ketë eksperiencë në mësimdhënie në IAL.
4. Të ketë kryer aktivitete shkencore si: referime, botime brënda dhe jashtë vendit.
5. Vlerësohen kualifikime të ndryshme në nivel pasuniversitar.

Kritere preferenciale:

1. Kanë preferencë kandidatët që kanë kryer kualifikime kombëtare dhe ndërkombëtare që lidhen me fushën përkatëse.

IV. Kandidatët që do të aplikojnë për këto vënde pune duhet të dorëzojnë këto dokumenta:

- a) Formular aplikimi;
- b) Letër motivimi dhe shprehje interesi për lëndën/modulin që kandidati aplikon.
- c) Një kopje jetëshkrimi i fokusuar në eksperiencat në mësimdhënie dhe botime shkencore;
- d) Kopje e noterizuar e diplomës/ve dhe listës/ve të notave. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njehsuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
- e) Dokumentacionin shoqërues përkatës të nevojshëm origjinal ose të noterizuar, sipas plotësimit të kriterëve të shpallura;
- f) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- g) Vërtetim i gjendjes gjyqësore (Dëshmi penaliteti/ formulari i vetëdeklarimit);
- h) Vërtetim nga qendra e punës për t’u angazhuar si pedagog me kohë të pjeshme në institucionin tonë. (n.q.s është i punësuar) (e detyrueshme) si dhe leja nga titullari i institucionit ku punon. (dorëzohet nëse shpallet fitues).
- i) Librezë shëndetësore nga Qendra Shëndetësore (dorëzohet nëse shpallet fitues).

V. Mënyra e dorëzimit të dokumentacionit

Dokumentacioni i plotësuar sipas kriterëve të shpallura të konkurrimit në njoftimin publik, bëhet me postë sipas afateve të shpallura:

- Vetëm paketat e aplikimit të mbërritura me anë të shërbimit postar pranohen dhe data në vulën e Postës Shqiptare do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të kandidatëve.
- Në zarf duhet të shënohet adresa e saktë e aplikimit; Universiteti i Sporteve të Tiranës, Fakulteti dhe Departamenti ku konkuron.

- Mosparaqitja e saktë dhe e qartë e këtyre të dhënave përbën shkak për mospranimin e paketës së konkurentit.

VI. Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët

- Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët është 5 (pesë) ditë pune nga data e publikimit të njoftimit. Kandidati duhet të plotësojë dokumentacionin e kërkuar brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e publikimit të njoftimit dhe e dorëzon atë të mbyllur në zarf me rrugë postare.
- VII. Të pranohet si kandidaturë qoftë dhe kur paraqitet vetëm një dosje, me kusht që kandidati të plotësojë kriteret.
- VIII. Deri në datën 29.10.2021, të ngrihet pranë Departamentit, Komisioni ad-hoc, i cili brenda datës 01.11.2021 duhet të vlerësojë dosjet e paraqitura. Pas shpalljes së listës me kandidatët vlerësues, afati i pritjes së ankesave është 2 (dy) ditë.
- IX. Departamenti përkatës në bashkëpunim me Komisionin ad-hoc është përgjegjës për ruajtjen dhe arkivimin e dosjeve si dhe të kontratave të lidhura me kandidatët fitues.
- X. Dekanati i FVFR-së, përcjell listën përfundimtare brenda datës 03.11.2021, për miratim në Rektorat.
- XI. Për zbatimin e Vendimit, ngarkohen: Administratori, Zv.Rektori i anës mësimore, Dekani i FVFR, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit si dhe Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Dixhitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për shpalljen dhe hedhjen e të dhënave në *Web-in* <http://www.ust.edu.al>.
- XII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Dr. Agron KASA

